



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.10254/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Liridon Maloku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit S.N. nga Peja, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati A.Sh. nga Peja, kundër debitorit A.S. nga Peja, për shkak të pagimit të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, EP.nr.1086/2020, të datës 27.10.2021, me datën 24.03.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa debitorit A.S. nga Peja, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë EP.nr.1086/2020, të datës 27.10.2021, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: PRANOHET i bazuar prapësimi i debitorit A.S. nga Peja, SHFUQIZOHET (vihet jashtë fuqie), urdhri përmbarimor i lëshuar nga Përmbaruesi Privat J.K. për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.509/20 e datës 02/11/2020, dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore, ndërsa propozimi për përmbarimi i kreditorit S.N., REFUZOHET I PABAZUAR.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, EP.nr.1086/2020, të datës 27.10.2021, e ka refuzuar prapësimin e debitorit A.S. nga Peja, i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor i caktuar nga Përmbaruesi Privat J.K. për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.509/20 e datës 02/11/2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozim që Gjykata e Apelit të anulon aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë EP.nr.1086/2020, të datës 27.10.2021 dhe çështjen përmbarimore ta pezulloj.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 30.10.2020, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit A.S. nga Peja, ndërsa Përmbaruesi Privat J.K. me datën 02/11/2020, nën shenjën, P.nr.509/20, e ka lejuar ekzekutimin, në bazë të dokumentit përmbarimor-aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1280/13 e datës 09/10/2015 i cili është i plotfuqishëm me datën 30/04/2020 dhe i ekzekutueshëm me datën 07/09/2020, në vlerën e përgjithshme për pagesë prej 13,000.00 euro.

Kundër urdhrit për përmbarim, debitori me datën 11.11.2020, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori me datën 20.11.2020, ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin EP.nr.1086/2020, të datës 27.10.2021 e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe e ka vërtetuar urdhrin përmbarimor duke arsyetuar se dokumenti përmbarimor-aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1280/13 e datës 09/10/2015, mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi paraqet dokument përmbarimor sipas nenit 24 të LPP-së.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore në raport me shkresat e lëndës, vlerësoj se ankesa e debitorit është e bazuar, për arsye se dokumenti përmbarimor-aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1280/13 e datës 09/10/2015 i cili është i plotfuqishëm me datën 30/04/2020 dhe i ekzekutueshëm me datën 07/09/2020, është prishur me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.531/20 e datës 06/10/2021 dhe lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim. Sipas nenit 71 par.1 nën paragrafi. 1.2. të Ligjit të Procedurës Përmbarimore është paraparë se prapësimi mund të bazohet nëse Dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik. Nga këto arsye, marrë për bazë pretendimin ankimor të palës ankuese se dokumenti përmbarues është prishur, Gjykata e Apelit i vlerësoj ndryshe provat nga shkresat e lëndës dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit dhe të refuzohet propozimi për përmbarim, ashtu siç është përcaktuar me nenin 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Sa u përket shpenzimeve të procedurës, u vendos konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së duke vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, pasi që e debitori nuk i kishte kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika c) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.10254/21, me datë 24.03.2021

Gj y q t a r i
Liridon Maloku